

**SHNDËRROJI FJALËT NË VEPËR
ÇFARË MUND TË BËJNË AKTERËT
KRYESORË PËR SIGURINË E
GAZETAREVE NË INTERNET**



osce

The Representative on
Freedom of the Media

SIGURIA E GAZETAREVE NË INTERNET

VEPRIMET E PROPOZUARA

DEGA EKZEKUTIVE E QEVERISË

1. Të hartohet një plan kombëtar veprimi për sigurinë e gazetarëve që adreson kushtet specifike për gazetaret;
2. Të aplikohen masa mbrojtëse të përgjegjshme gjinore;
3. Të mblidhen të dhëna për sulmet ndaj gazetareve për të shërbyer si bazë për politikat dhe hulumtimet, si dhe për t'i mbështetur fushatat e ndërgjegjësimit që synojnë angazhimin e vendimmarrësve dhe opinionit publik;
4. Të raportohet për sigurinë e gazetareve tek mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe të integrohet kjo çështje në politikën e jashtme.

DEGA LEGJISLATIVE E QEVERISË

1. Të rishikohen dhe, po të jetë e nevojshme, të plotësohen e ndryshohen ose miratohen ligje për të promovuar një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj sigurisë së gazetarëve;
2. Të sigurohet që legjislacioni që adreson ngacmimet dhe abuzimet në internet ndaj gazetareve të mos minojë të drejtën e lirisë së shprehjes.


GJYQËSORI

1. Të ketë vetëdijësim për çështjet gjinore në të gjithë sistemin gjyqësor, meqë kjo është qenësore për mbrojtjen e gazetareve;
2. Të rritet ekspertiza e personelit gjyqësor për çështjet e lirisë së shprehjes, sigurisë së gazetarëve dhe ngacmimit e abuzimit në internet dhe jashtë tij;
3. Të zbatohen dhe promovohen praktikat më të mira në qasjen në drejtësi, dënime dhe mjete juridike;
4. Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut duhet të angazhohen në çështjen e sigurisë së gazetarëve.

DEGA LEGJISLATIVE
E QEVERISJES



AGJENCITË E
ZBATIMIT TË LIGJIT



NDËRMJETËSIT
E INTERNETIT




ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE
DHE INSTITUCIONET ARSIMORE



ORGANIZATAT
NDËRQEVERITARE

#SOFJO



ORGANIZATAT E
GAZETARËVE DHE
ORGANET VETËR-
REGULLUESE



AGJENCITË E ZBATIMIT TË LIGJIT

1. Të avancohet trajnimi i autoriteteve të zbatimit të ligjit lidhur me çështjet e sigurisë së gazetarëve në internet, me një qasje të përgjegjshme gjinore;
2. Të rishikohet dhe përmirësohet trajtimi i çështjeve gjinore në vlerësimet e rrezikshmërisë për kërcënime dhe ngacmime;
3. Të përfordhen protokollat, metodat dhe procedurat e hetimit të krimeve kundër gazetarëve dhe lirisë së shprehjes;
4. Të avancohet dialogu dhe bashkërendimi për sigurinë e gazetarëve midis autoriteteve të zbatimit të ligjit, mediave dhe shoqërisë civile.

ORGANIZATAT NDËRQEVERITARE

1. Të integrohen qasjet me ndjeshmëri gjinore brenda standardeve dhe mekanizmave për të drejtat e njeriut lidhur me sigurinë e gazetarëve;
2. Mbështetje për Shtetet në adresimin e mangësive në zbatim të standardeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve;
3. Ndihmë në rritjen e të dhënave dhe hulumtimeve që të shërbejnë si bazë për nismat për sigurinë e gazetarëve në internet;
4. T'i jepet përparësi bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktorëve për të fituar ndikimin e duhur.

NDERMJETËSIT E INTERNETIT

1. Të respektohen standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi lirinë e shprehjes, privatësinë, pjesëmarrjen dhe mosdiskriminimin në politikë dhe praktikë;
2. Të sigurohet që politikat për redaktimin e përmbajtjeve të jenë të qarta, transparente dhe të arritshme për përdoruesit, si dhe që përdoruesit të jenë të vetëdijshëm për mënyrën e redaktimit të përmbajtjes, çfarë përbën ngacmim dhe abuzim në internet, si dhe si ta raportojnë atë;
3. Të zbatohen qasje të përqendruara tek përdoruesit, si dhe pa bazë në diskriminim, në të gjitha operacionet;
4. Të trajtohet largimi i përmbajtjeve dhe kërkesat e përdoruesve për të dhëna me transparencë dhe konsistencë;
5. Të promovohet roli i grave në gazetari.

MEDIAT

1. Të përmirësohet kultura e mjedisit të punës me politika gjithëpërfshirëse si për sigurinë ashtu edhe për gjininë;
2. Të sigurohet mbështetje dhe trajnim për gazetarët të cilët përballen me ngacmime dhe abuzime në internet;
3. Të hartohen udhëzime për komunitete të përgjegjshme ndaj gjinisë për platforma interaktive në internet;
4. Të monitorohet dhe dokumentohet abuzimi dhe ngacmimi në internet i gazetareve, përfshirë profesionistët e pavarura.

ORGANIZATAT E GAZETARËVE DHE ORGANET VETËRREGULLUESE

1. Të shtohen veprimet dhe avokimi kolektiv për të përmirësuar sigurinë dhe kushtet e tjera të punës për gazetarët;
2. Të konsolidohen kapacitetet përmes rrjeteve mes kolegëve, trajnimeve dhe mbështetjes tjetër praktike;
3. Të dokumentohen sulmet dhe informatat të përdoren për ndërgjegjësim të aktorëve kryesorë;
4. Të promovohet përfshirja e çështjeve të sigurisë dhe barazisë gjinore në punën e organeve vetërregulluese.

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE DHE INSTITUCIONET ARSIMORE

1. Të shtohen të dhënat, njohuritë dhe ndërgjegjësimi i aktorëve kyç dhe shoqërisë në përgjithësi mbi ngacmimet dhe abuzimet me bazë gjinore në internet;
2. Të bashkohen forcat për të avancuar zbatimin e standardeve të sigurisë dhe kushteve tjera të punës për gazetarët në nivel kombëtar;
3. Të zhvillohen trajnime dhe materiale edukuese për mbrojtje gjithëpërfshirëse;
4. Të integrohet siguria e gazetarëve dhe barazia gjinore në aktivitetet e edukimit dhe trajnimit për gazetari.

GAZETARËT DHE PUNONJËSIT E MEDIAVE

1. Të monitorohet dhe vlerësohet peizazhi i rrezikut për gazetarët;
2. Të praktikohet qasje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë, duke përfshirë sigurinë fizike, ligjore, psikosociale dhe atë digjitale;
3. Të dokumentohen dhe raportohen kërcënimet dhe sulmet;
4. Të mbështeten kolegët që përballen me abuzime dhe ngacmime në internet, dhe ata që janë në rrezik më të lartë të përjetojnë sulme të tilla;
5. Informim më i madh për format e mundshme të mbështetjes, përfshirë mekanizmat ligjorë.



Përballja me një shtresë shtesë të rrezikut

Gati dy në çdo tri gra gazetare janë kërcënuar ose ngacmuar në internet. Vetëm për shkak të gjinisë së tyre, gazetaret përballen me një shtresë shtesë të rrezikut, krahas sulmeve që të gjithë gazetaret po i përjetojnë gjithnjë e më shumë. Askund nuk e shohim këtë formë të ngacimit dhe abuzimit më ashpër sesa në sferën e internetit.

E pengon lirinë e shprehjes

Ngacimi dhe abuzimi në internet ndaj grave gazetare është shndërruar në rrezik të madh për profesionin, duke kërcënuar aftësinë e gazetareve për ta bërë punën e tyre. Ai cenon të drejtën e tyre për liri të shprehjes aq sa pengon qasjen e lirë dhe të hapur në informacion për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. “Kam menduar që t’i mbyll tërësisht llogaritë në mediat sociale”, thotë redaktorja politike e BBC, Laura Kuenssberg, në dokumentarin “Një vend i errët”, të realizuar nga Përfaqësuesi për Lirinë e Medias (PLM) në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të Shtypit. “Por pastaj, ata që mbesin atje, që dëshirojnë informacion, gjë që është gjëja më e rëndësishme për mua, atëherë ata humbin, dhe pastaj edhe unë humbas”.

Ndikon në cilësinë e demokracive tona

Thënë shkurt, siguria e gazetareve në internet rrezikon drejtpërdrejt cilësinë e demokracive tona. Ky udhëzues burimesh #SOFJO ofron përgjigje ndaj këtij kërcënimi, duke propozuar veprime për të forcuar mënyrën se si adresojmë sigurinë e gazetareve në internet.

Platformë për ndërgjegjësim

Duke filluar nga viti 2015, projekti “Siguria e gazetareve në internet” (SOFJO) ka gjeneruar nisma inovative dhe të qëndrueshme. Ai është kthyer në platformë për ndërgjegjësim, për krijimin e strategjive kolektive dhe ndarjen e mjeteve dhe burimeve për gazetaret të cilat kanë qenë cak i sulmeve. Konferencat, takimet në grupe të mbyllura dhe fushata e komunikimit me mediat sociale #SOFJO kanë ndihmuar në krijimin e një rrjeti mbështetës nga qeveritë, organizatat e mediave, akademia dhe aktorët e shoqërisë civile në të gjitha Shtetet pjesëmarrëse.

Praktika të mira dhe veprim i mirëfilltë

Ky udhëzues i burimeve #SOFJO synon të ndihmojë Shtetet dhe aktorët jo shtetërorë në të gjithë rajonin e OSBE-së në ndërmarrjen e veprimeve reale për ta përmirësuar sigurinë e gazetareve në internet. Praktikrat e paraqitura janë që të gjitha shembuj të mënyrave në të cilat mund të realizohen standardet dhe zotimet ndërkombëtare. Ato shpalosin një qasje sistematike për aktorët që janë thelbësorë për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mundësues mediatik, duke pasqyruar 40 veprime të propozuara.

Angazhimi i gjithë aktorëve kyc

Është shumë e nevojshme të ketë qasje shumëpalëshe. Udhëzuesi i burimeve #SOFJO u ofron aktorëve kryesorë përzgjedhje të shkurtër të hapave më të rëndësishëm dhe të arritshëm. Shembuj konkretë të praktikave më të mira, të vendosura nga aktorë të ndryshëm në vende të ndryshme, ilustrojnë secilin veprim të propozuar. Një përzgjedhje e burimeve të dobishme e përplotëson këtë listë. Në fund, ai përmban një pjesë rreth standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që, gjatë dekadës së fundit, gjithnjë e më shumë bëjnë thirrje për një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj sigurisë së gazetareve.

Koha për t'i shndërruar fjalët në veprim

Të marrë së bashku, këta hapa formojnë një strukturë të ndërlidhur në të cilën gratë gazetare mund ta vazhdojnë profesionin e tyre në internet në një mënyrë më të sigurt. Fatkeqësisht, nuk ka asgjë virtuale në lidhje me këtë formë të ngacimit dhe abuzimit. Është një problem real që kërkon zgjidhje reale.

Është koha për t'i vënë fjalët në veprim.

A UDHZUESI BURIMOR #SOFJO
osce.org/fom/sofjo



Ndiqeni Përfaqësuesin e OSBE-së për Liri të Mediave



Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Liri të Mediave

Wallnerstrasse 6
A-1010 Vienë, Austri

E-mail: pm-fom@osce.org www.osce.org/fom

© 2020 Zyra e Përfaqësuesit për Liri të Mediave e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE)

OSCE

The Representative on
Freedom of the Media